



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË TETË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **26.09.2019, (e Enjte)**, në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10h. mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, si dhe këshilltarët e Kuvendit: Basri Sylejmani, Zejnepe Osmani, Valbona Haziri, Ramadan Deliu, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Taibe Ibrahimimi, Zekirja Zuka, Nijazi Isaku, Jakup Demiri, Sejdi Emini, Remzi Salihu, Mirlinda Sadiku, Liridona Bislimi, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Valentina Hasani, Vehbi Rama, Rasim Terziqi, Besim Ymeri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, KDI-së mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 27 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e tetë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Tani kalojmë te pyetjet jashtë rendit të ditës.

z.Bekim Azizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Në mbledhjen e KPF-së, ajo mbledhje nuk ka përfunduar, sepse aty ka kaluar rendi i ditës dhe pas kalimit të rendit të ditës nuk ka pas korum dhe mbledhja është ndërpre dhe është një shkelje që e ka bërë sot, shkelje e radhës që po bënë rregullisht, që në mbledhje të KPF-së nuk e ke përfunduar po ke thirr seancë të drejtpërdrejt. Ky është një gabim që e ka bërë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit Bekim. Ne në KPF kemi diskutuar, kemi debatuar rreth detyrave të KPF-së. Është e vërtetë që unë e kam përfunduar mbledhjen për shkak se nuk kemi pas kuorum, njëkohësisht kemi elaboruar këtë çështje jashtëzakonisht shumë, aty unë e di që ju si KPF ju keni drejtuar MAPL-së me një shkresë dhe natyrisht e di që e keni marrë përgjigjen dhe e kemi diskutuar edhe në KPF. E dini cila është përgjigja e MAPL-së. Unë si kryesuesi i kuvendit jam i obligueshëm me thirr kuvendin edhe për faktin se e kemi afatin e fundit për miratimin e buxhetit. Unë konsideroj që nuk kam bërë shkelje, e ju e keni të drejtën që të ju drejtoni organin kompetent i cili e bënë ligjshmërinë e të gjitha këtyre çështjeve, dhe nëse është shkelje unë jap përgjegjësi.

z.Bekim Azizi: Edhe përgjigja nga MAPL-ja nuk është dhënë e kështu, aty është përshkruar ligji ashtu qysh e dini na. Pyetja ka qenë, a ka të drejtë kryesuesi me thirr seancë, po jo, nuk është kthyer përgjigje. Ajo çka e ka thanë MAPL-ja, atë edhe ne e dimë, nuk ka të drejtë të me thirr këtë formë seancë, nuk ka thanë që të ke të drejtë pa e përfunduar mbledhjen e KPF-së, sepse ti e ka kaluar rendin e ditës dhe mbledhja është e pa përfunduar. Ti nuk mundesh me thirr seancë në kuvend pa e përfunduar rendin e ditës në KPF.

z.Naim Pira: Ju prapë e keni mundësinë që të ju drejtoheni me pyetje shtesë organit kompetent, i cili e bënë vlefshmërinë e akteve apo përgjigjen e akteve. Unë për hir të disave që nuk e kanë pa përgjigjen e MAPL-së, po i lexoj vetëm disa nga pikat e kësaj kërkesë dhe një nga pikat thotë: “KPF-ja nuk mund ta bllokoi punën e Kuvendit të Komunës në funksionimin e tij dhe në nxjerrjen e vendimeve”, për shkak se kuvendit i komunës, bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, është organi më i lartë në komune, i cili zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejt

nga qytetaret. Andaj MAPL-ja kërkon nga ju, që roli i juaj proaktiv si anëtarë të KPF-së, të ndikoj në nxerrjen e vendimeve kualitative në kuvendin e komunës përmes rekomandimeve të KPF-së.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Çështja e KPF-së dhe e kuvendit është seanca e pestë ose e gjatë që i kemi të njëjtat problematika, që po i bisedojmë. E kërkova fjalën para që kryesuesi me e lexu shkresën, njoftimin, sa i përket punës së KPF dhe të kuvendit. Ke shumë e kuartë e shtjellume, nuk mundet me pengu KPF-ja punën e kuvendit. E kam cek edhe në seancën e kalume. Deri sa KPF-ja është derivat i zgjedhur prej kuvendit edhe MAPL-ja shumë mirë po e precizon dhe po e shtjellon, po me duket janë shtjerr krejt mundësitë edhe ligjore edhe morale e etike. Sa i përket kësaj pike, po këshilltari e ka të drejtën vet me mendu e me votu sipas bindjes së tij. Interesi i qytetarëve është, që kuvendi të punon me rregullaritet dhe në interes të tyre dhe edhe këto pika janë me rëndësi jetike për qytetarët e Komunës së Vitisë.

z.Bekim Azizi: Këtë pikë jemi tu e diskutu kogjo gjatë, na jemi koqit, është çështje e pagatishmërisë tënde kryesues, është pak tek mendje tanë tu mendu që do ta vazhdoni. Parafolësi im tha, nuk e lejon çështja as etike as morale. Unë mendoj që kësaj here nuk e pat mirë, sepse e ka gabim edhe ai që u kyç në këtë formë, sepse asnjëherë nuk e ka pengu KPF-ja Kuvendin. KPF-ja ka të drejtë me rekomandu ose mos me e rekomandu pikën në kuvend. Kemi vepru njëjtë, ka të drejt me votu për, ka të drejtë me votu kundër, që njëjtë e kemi bë kur kemi dash e kemi votu pro, kur kemi dashtë kundër. Na e kemi kry obligimin ligjor që na takon, ne për çdo pikë kemi dhënë kontributin tonë. Unë thash nuk e ke kry mbledhjen e KPF-së, ti ka qenë dashur prapë me thirr KPF-në, me vazhdu mbledhjen, sepse mbledhja nuk është përfundua, kjo është shkelja që e ki bë ti.

z.Ali Bajrami: Unë vetëm kërkova ajo çka shkrun që me punu dhe me u zbatu ligji, kurgja tjetër nuk thash, at që e mendon ti ajo është çështje e jotja personale.

znj.Mirlinda Sadiku: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Fillimisht dua të them që sot kur e kemi në pikë të rendit të ditës buxhetin, ka qenë dashur të jete kryetari këtu. Unë isha ndërlihd me përgjigjen që ka ardh nga MAPL-ja, ku thuhet që KPF-ja duhet të nxjerr rekomandime kualitative, ku përmes rekomandimeve të tyre i dërgon në kuvend, shumë herë ju mundoni të jeni me baraspesh në aspektin demokratik po me trego cilat rekomandime që i ka propozu LVV, se ka fillu qysh nga korniza afatmesme buxhetore, cilat rekomandime i ki shti në kornizë, asnjë, përkundër komunat tjera të cilat kanë praktika shumë të mira që edhe roli i opozitës është shumë konstruktiv dhe mirre parasysh, ndoshta jo 20 rekomandime po të paktën 4-5 që mendoj që janë për qytetarët, sepse edhe ne përfaqësojmë qytetarët, d.m.th asnjë nuk është marr parasysh, ke mujt me vendos në kornizë që këto janë rekomandimet e grupit parlamentare qoftë PDK, VV, AAK po ju nuk e keni marr parasysh asnjëherë dhe nëse kronologjik shikohet aty rrjedhe gjithë ajo që e ka sjell edhe këtë që po e potencon Bekimi, me plotë të drejtë atëherë shtrohet një pyetje logjike, pse ekziston KPF-ja. Nëse e shikojmë sipas udhëzimit administrativ dhe Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ai e përfaqëson shumicën e kuvendit, d.m.th e reflekton përbërjen politike, edhe aty përcaktohen politika fiskale, buxheti shtjellohet, diskutohen, rekomandohet po jo bash asnjëherë nuk e keni marr parasysh, prandaj nuk keni alibi në këtë drejtim. Dashta me bë pyetje për drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e kemi një germadh atje ne Pozharan, shkrinë aty pallati rinor. Nuk e di cili është statusi i saj edhe ajo është taman si germadh, asnjëherë nuk është mendu për me hy në funksion çka ka ndodh me këtë dhe trotuari në rrugën “Hajdin Demiri” ka fillu dikun nga Pranvera, po me sa e pash unë, një pjesë e tij asnjëherë nuk është përfundua a keni përgjigje për këtë.

z.Naim Pira: Sa i përket asaj germadhe që po e thua ti, ajo është pronë private, ajo është privatizu në vitin dikune 2012, kemi bë përpjekje maksimale më von të mbetet si aset i komunës, ku qytetarët e Pozheranit ta shfrytëzojnë si pallat rinor, mirëpo fatkeqësisht pronari nuk e ka gatishmërinë, sepse ka pagu pare dhe prona private është e shenjt dhe kështu që nuk mundemi se çka me bë aty, ndërsa përskaaj kësaj është tu bë një ambient i shkëlqyeshëm në të dy shkollat, aty po behet një park i shkëlqyeshëm.

z.Nijazi Isaku: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë e pash at shkresën e MAPL-së, ajo shkresë është vetëm përgjigje në kërkesën që e kane parashtu, jo nuk është naj far vendimi që është në kuptimi i ligjshëm dhe imponues ndaj kuvendit, mirëpo ti e ceke që ligjshmërinë e akteve jav kanë miratu. Kjo është krejt tjetër sen, ama ajo si shkresë edhe vetëm përgjigje në kërkesë, ama ajo nuk imponohet. Unë pajtohem me rolin e kuvendit, mirëpo tani duhet të shtojmë pyetje, pse duhet të ekziston KPF-ja nëse aty bëhen rekomandime që ato rekomandime vinë këtu edhe votohen apo nuk votohen, atëherë është mirë hiq mos me ekzistu KPF-ja, sepse unë mendoj që këtu ka hapësira ligjore. Unë mendoj që duhet të respektohen edhe opozita në KPF, e nëse rekomandimet e opozitës nuk përfillen në KPF, po na mbetet neve ky veprim që çdoherë me këtë mundësi tonë mos me qenë pjesë as votimet që ndodhin mas pikave të rendit të ditës, e unë mendoj që ju si pozitë duhet me lëshu pej pak që mi pas parasysh edhe rekomandimet tona.

znj. Hidajete Pira: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë dua të ngris një shqetësim lidhje me ndeshjen futbollistike që është bë në Sadovinë, është shqetësim i pozharanasve dhe i klubit “Vllaznia”, problemet, ekceset që janë shkaktu gjatë ndeshjes të Dielen e kaluar, ndërmmjet kf “Vllaznia” dhe “Vitia”, ku si pasoj shumë shikues kanë marr lëndime trupore, besa kanë kërkuar edhe ndihma mjekësore e disa prej tyre kanë pas edhe intervenime kirurgjike. E gjithë kjo lidhet me vendimin qëllimkeq të kryetarit dhe bashkëpunëtorëve të tij që gjeten formulën për të ja marr fushën ndihmëse që e fituan klubi i “Vëllaznisë” me mundin edhe punën e vet dhe e cila ju dhurua nga UEFA. Ne si subjek e kundërshtuam me ngulëm që fushat të mos shkoj në Sadovinë po të vendoset aty ku klubi dëshiron dhe Pozharani, mirëpo fatkeqësisht nuk patëm përkrahje. Kam pyetje për kryetarin, edhe pse nuk është këtu i pres përgjigjet më von. Pyetja nr.1, a është ndërtuar kjo fushë ndihmëse e futbollit ne pronë private apo shoqërore? Pyetja nr. 2, si do ta kishit ndie veten ata që votuan pro fushës në Sadovinë po të kishte pasur ndonjë të vdekur? Pyetja nr. 3, ku do t’i zhvillojnë stërvitjet apo ndeshjet kf “Vllaznia”, pasi që ma aty nuk ka siguri, edhe pse është dashtë kf “Vllaznia”; Pyetja nr. 4, kur përfundojnë punimet e zvarritura të fushës në Pozharan apo ndoshta kryetari e ka mendu këtë fushë që të shfrytëzohet për dy stinët, edhe për verë dhe për dimër. Verës do ta bëjë si pishinë e dimrit si patonazh.

z.Naim Pira: Sa i përket incidentit që ka ndodhe në fushë, besoj që çdo qytetar e gjykon, sepse vërtet ka qenë një aksident që ka pas të lënduar. Për këtë çështje do të merren organet e rendit, organet gjyqësore, ta gjejnë fajtorin, sepse fushat e gjelberta janë për ta zhvilluar aktivitetin sportiv dhe jo aktivitet të tjera. Unë i ftoj të gjithë akterët që kanë qenë aty, po natyrisht edhe klubet, që ta krijojnë bashkëpunimin e mirë dhe sporti që e kane pas në vazhdimësi “Vitia” dhe “Vllaznia” e Pozharanit, shpresoj shumë që në buxhetin që e kemi sot, ku do të miratohet e kemi planifiku edhe ndërtimin e fushës ndihmëse, e cila do të ndërtohet sigurisht në Pozharan nëse gjejmë vend.

z.Sejdi Emini: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Po më duket që krejt po i ikni fushatës, e që unë mendoj që është e domosdoshme që ja sot me bë fushatë ja kurr, qështu mendoj unë. Mos u frigoni, mobilizoni qytetarët e Komunës së Vitisë, votat të cilat janë orientu me e votu subjektin politik nalni në Viti ato vota, sepse e dimi shumë mirë qysh i kemi bart ato pasoja prej vendeve dhe regjioneve tjera, andaj unë kisha bë një thirrje jo vetëm juve si kuvendar që i përfaqësojnë qytetarët e Komunës së Vitisë, po të gjithë qytetarëve të Komunës së Vitisë, që votat për deputet t’i i ndalim ne Viti. Bile bile, po më dhem bukur shumë kur po i shoh do që po vinë këtupari, e thamë haptas mos u mshefni, po bëj apo nuk po bëjë fushatë. Kryesues, bën thirrje me bë fushatë, është momenti i fundi me bë fushatë, me ju tregu që jemi gjallë dikun. Nuk mu priset qefi edhe 10 deputet me i qu, po së paku nja 5 le të shkojnë, mos të ju vjen keq, ju e dini që qëllimi im është me bë ndryshim, këtë e thamë haptas, po nuk mu priset qefi me shku edhe 10 prej Vitisë, andaj mos u mshefni, e dimë sa pasojat i kemi pësu për kyqjen në autostradë, pikërisht se për shkak të fuqisë tonë jav kemi dhënë tjerëve. Kërkoj që të nalen votat ne Viti për kandidatët tanë, qeta që i kemi. Kam qenë idhëtar i punëve të mira, që punët kur të fillojnë me përfundu deri në fund. Në fshatin Goshicë është një rrugë e arave që është shtru tash frik, e që është shumë mirë që është shtru një pjesë, po pjesa tjetër ku janë edhe mbi 50 hektar ka mbet pa u shtru, ku ata banor janë zhgenjy pak. Kam obligim këtu, porosi prej

tyre, që edhe ajo pjesë me u shtru, pjesa tjetër, që ku para se me ardh rasisht e takova, ishin edhe koleget me të cilët jemi në grup. Një banor, Xhfer Beqiri, më ndali në rrugë dhe memxi me la me ardh ne kuvend. Janë 18 shtëpi, ai po kërkon llogari, po thotë çka ju kam bërë unë atyre që po me llogarisin qytetar të dorës së dytë. Hajde tha kshyrne a mundesh me dal andej, mendoj që nuk e meritojnë ata këtë, mendoj që duhet me e trajtu krejt njëjtë. Rrugët do të kryhen krejt jo vetëm politikisht. Doktoreshë, Pozharani dhe Vitia nuk i ndaj, janë një, mos të bëjmë urrejtje, sepse një pjesë të fajit e mbajmë edhe ne, sepse nuk kemi gjyku drejt qysh është dashtë me gjyku, nuk kemi faj po urrejtje mos shti edhe këtë thirrje e bëjë publike, mos të bëjmë urrejtje.

znj.Idajete Pira: Unë nuk shtina kurrfar urrejtje dhe nuk ceka as “Vitinë”, vetëm e ceka ndeshjen ndërmjet “Vllaznis” dhe “Vitise”. Unë pata pyetje, si do ta ndihni veten nëse një i lënduar nuk e ceka se i kahit është.

z.Sejdi Emini: Nuk tu drejtova personalisht ty, e thash për krejt, të gjithë neve, edhe veten e shtina qaty. Unë kam qenë dëshmitar i asaj ngjarje, ka qenë trishtuese, nuk e di qysh me thanë, ka dashtë Zoti dhe kanë pshtu në këtë mënyrë qysh kanë pshtu, ka qenë tmerr ajo situatë qysh ka qenë. Unë nuk e arsyetoj as njërën anë aty që kanë qenë, ka dash Zoti kemi pshtu, sepse ka pas me pas pasoja qe ndoshta dikush është dashtë mi bart ato pasoja. Po fatmirësisht ka kalu me atë.

z.Taulant Haxhiu: Të nderuar të pranishme! Unë kam një vërejtje. Shumica e drejtorëve nuk po janë këtu, ndoshta janë në fushatë dhe po injorohet puna e asamblesë komunale, drejtoresha Fatbardha Emini që ka punë me së shumti këtu, ajo më së shumti mungon në seanca. Kam një pyetje për z.Ibrahim Ramiqi. Unë këtë për çështjen e urës të shkolla e mesme, kam kerku që 10 seanca për shkak se qytetarët po vinë tek unë dhe po kërkojnë që këtu ka një keq përdorim të vlerës prej 219 mijë euro. Në seancën e kalume me ke premtu që me mi sjell informacionet e duhura, besoj që sot mi ki sjell. Për ditën e Diell, ne e kemi pas propozimin që dita e Diell të jet dite pushimi, e kemi pas një takim me bizneset, 95% të bizneseve janë kanë që të jetë dita e Diell ditë pushimi, këta prapë nuk e kanë sjell në kuvend, ka pas me votu për shkak se bizneset me të mëdhaja në Komunën e Vitisë e kane përkrah këtë propozim, e ka përkrah shumica e kuvendit, dhe tash përsëri nuk ka ardh kjo si pikë e rendit të ditës. E kam edhe një pyetje për z.Nexhmedin Jakupi. Te rruga “Adem Jashari”, pas banesave, nuk e di a e ki pa ndonjëherë sa bërllogu e sa shiringa është mbrapa aty, nuk diet a je në Viti apo në fallugj. Është mirë aty të shkon e ta pastron vendin, kurse për punën e stadiumit, dëgjo mirë doktorresh, po të ish kanë Sokol Haliti i Pozharanit, e kishe bërë të pamundurën për me sjell stadiumin në Pozharan, po ka qellu Naim Pira dhe u kane qe ka leshu pej e këtë fushë e ka marr Sadovina pa meritë, se ajo i ka taku vetëm Pozharanit. E keni votu Naim Piren, nuk u kanë burrë që i ka përkrah banoret që e kanë bërë kredibil në politik.

z.Naim Pira: Kualifikimet e tilla nuk i pranoj nga njerëz të tillë dashakeqi, që nuk ja do, ose me se paku ti ja do të mirën “Vllaznisë”. Dikujt ndoshta i duhet me shku te psikiatri, unë nuk kam probleme, mos politizo me stadiumin e “Vllaznisë” së Pozharanit. Nëse është dikush fajtor për mos fillimin e punëve në stadione, është pikërisht partia jote dhe ministri yt që e keni pas, ku 422 mijë euro që dy vjet e keni blloku partija juaj dhe ministri yt. Unë jam ai që kam shkuar mbi 10 herë në ministri atje dhe e kam ngrit këtë çështje, ndërsa stadiumi do të ndërtohet në Pozharan deshtë apo nuk deshtë ju, “Vllaznia” do ta ketë stadiumin e vet.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Deshta mu lidh me KPF, sepse jam pjese e këtij komiteti. Në mbledhjen e fundit nuk kam qen prezent, i kame arsyet personale të mijat, deshta me thanë që nuk ka qenë puna të paktën e LVV në KPF bllokimi i atij komiteti apo i kuvendit, po edhe ky komitet e ka hup më arsyen për me funksionu për me ekzist. Ne edhe në aspektin profesional i kemi ofru gjithë pikat të cilat pajtohem apo nuk pajtohem me buxhetin, ndërsa asnjëherë asnjë pikë nuk është marr për bazë dhe besoj që edhe vet ju pajtoheni se buxheti nuk e keni në rregull, sepse nuk bëhet ashtu kur e anashkalon një pjesë që është gjysma e qytetarëve të Vitisë, nuk pyetet e që është kundër këtij far projektbuxheti, atëherë për çka me më funksionu KPF, për çka me ta votu nëse ki marr ti konkluzionet e tona, edhe na nuk e kemi votu atë, atëherë ke të drejt me thanë që je bllokues, po ju kurrë nuk e keni marr parasysh asnjë rekomandim ki rekomandime që edhe ligji ta përcakton tani ne kemi

edhe telashe të tjera, si me prioritetet e fshatrave ishte ne takim nënkryetari që e patën në Smirë, që ku e kemi edhe Zeken këtu, i ka pas prioritetet e mëhershëm, po punët të cilët i ka kry komuna ne fshatin tim në Smirë, nuk janë asnjë prej atyre prioriteteve që i ka përcaktu qytetari, po janë prioritete që janë përcaktu nëpër gjyzidija, e tani më thoni jeni bllokues jo bllokues, ama përnime duhet me e blloku me qytetar, me javë qel sytë krejtve, sepse na jemi të zgjedhur prej qytetarëve, kerkush nuk na ka pru këtu. Unë ka mu kanë zë i fuqishëm i të drejtës dhe i qytetarit, pavarësisht se qysh më vlerësoni e me etiketoni ju, KPF-ja është më mirë të mos ekzistoj fare, o mos u thirrni në ta, sepse e keni degradua gjithçka, edhe Kuvendi Komunal në Viti është degradu, nuk ka votë të sinqertë, po vetëm sa me i kalu do sene, ndaluni mendoni se çka kemi bë të mirë në Komunën e Vitisë, i kemi rrugët me cilësi jashtë standardit, pagesat janë mbi nivelin që parashihen disa komuna tjera, kemi premtime tash prej komunës ku janë zotu këtu që kane me u riparuar, njëra u shtru e tjetra nuk është shtru. Masi nuk e kemi nënkryetarin këtu në rregull, vitin e kaluar i ki pas nga LVV 23 rekomandime, asnjë nuk e ki marr për bazë e as nuk i ki shkru, bile prapë të njëjtën sen po e bënë edhe këtë vit, e mos na quaj neve bllokues, mirëpo nuk po do me pas bashkëpunim.

z.Remzi Salihu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kam pyetje rreth punësimeve, si është mënyra dhe metoda e të punësuarve në Komunën e Vitisë. P.sh.: në çerdhe shpallet një konkurs për katër vende të lira të punës me procedurë të thjeshtësuar. Shtrohet pyetja, si erdhi pikërisht në këtë kohë një konkurs i tillë në kohën e fushatës dhe çfarë po punojkan këto edukatore deri me 31.12.2019 dhe çfarë emergjente të koka aty. Dhe pyetja dytë, ne gjimnazin “Kuvendi i Lezhës”, me sa kam përcjell unë, kanë qenë dy konkurse, njëri për psikolog e tjetri për një sociolog. Po aty kanë ardh pesë punëtor të ri, nuk e di çfarë mënyre janë ardh. Një koleg i yni, Ekremi, ka thanë mënyrën se si punësohesh në Komunën e Vitisë, se çka duhet me qenë me u punësu në Komunën e Vitisë, nuk po e citoj për shkak të origjinalitetit.

z.Ali Bajrami: Unë kam një falënderim ne emër të banorëve të fshatit Goshicë dhe Germovë për përfundimin e rrjetit të ujësjellësit që ka përfundu pus është rruga e malit ne gjatës prej 815 metra që ka përfundu vetëm një shpjegim rruga e arave na e dim qfar gjendje ka qen ka qen ne gjendje të pa kalushme është shtru me zhavorr një pjes është shtru me asfalt është tu bisedu që edhe pjesa tjetër me u shtru me përfundu se e meritojn edhe ata banor gjatësia është dikune 250-300 metra edhe jam shume i bindur që edhe ai aks rrugor që ka mbete ne Goshic do të përfundoj dhe qytetaret e asaj pjese do të shkelin ne asfalt e jo ne zhavorr se lloqin ne Gohic moti e kemi hek.

z.Sejdi Emiri: Po më vjen shumë mirë që po e përmend Goshicen, je kanë aty prezent atë ditë që është shtru “Rruga e malit”, e di ku ka përfundu, e di që shumë familjar tu kanë shumë hektar natana dhe kanë met, është e pa kalume. Sa i përket rrugës së arave, edhe Sametit i kish ra ndermet, po nuk e di pse nuk e ka thanë hala, sepse ka do miq aty, sepse ata banorë kanë met të dorës së dytë që nuk e meritojnë ata banorë, ku janë 18 shtëpi aty, e dikujt për një shtëpi i ka shku asfalti në oborr. Dikush duhet me dhanë llogari, e ai është kryetari që duhet me dhënë llogari. Sa i përket ujësjellësit mirë që ka përfundu rrjeti, ama gypi është shumë i hollë, mirëpo qaj ujësjellës nëse asnjëherë nuk ka me na bë rahat, nuk e di unë tash, gjysma e lagjes është knej e gjysma knej, qysh kanë me deportu ata mu kyq me e pre asfaltin 50 vende, apo. Jo more kjo nuk është në rregull, ai projekt ka fillu që 12 vite, bile na kanë pare borxh komuna. Kemi bisedu, e dinë drejtori, ka qen korrekt dhe dikun rreth 5000 euro ja të qytetarëve në komunë te CDI-ja, le të ja kthen qytetarëve.

z.Taulan Haxhiu: Kryesues, me thave që je keqbërës i “Vllaznis”, unë për “Vllaznin” kam respekt, sepse edhe kam votu pro “Vllaznis”. Më thave që duhet me më qu në trajtim psikik, unë të respektova për shkak se e ki pas një problem, e thash mos u nxe, e unë nuk kam nevojë me shku në trajtim psikik, sepse jam një njeri që gjatë gjithë rrugëtimit tim kam pas progres, edhe pse kam hi në politik, punët time që e kam si afarist e kame udhëheq siç është me së miri. Një njeri që mundet me pas probleme psikike është ai njeri që gjatë udhëtimit kalon në regres dhe atëherë i shfaqet dhe duhet trajtim psikik, kurse unë gjatë gjithë rrugëtimit tim kam pas vetëm progres dhe për at jam energjik dhe i mbroj meritat e qytetarëve të Vitisë.

z.Naim Pira: Sa i përket progresit, nuk ka çka e diskutojmë, se unë progresin të kam kry para nja 30 viteve dhe besa i kam do tituj në raport me të tjerët, po kurrë asnjëherë nuk e kam bërë transparente, sepse kam qenë të jem modest.

z.Ali Bajrami: At dit kur ka fillu rruga e malit, kemi qenë aty, ka qenë edhe administratori, kanë qenë edhe qytetarët. Kërkesa prej administratorit dhe këshillit të fshatit është bërë për 815 metra, rruga prej asfaltit deri te reka ose te mulliri i votve që i thojmë na i ka 815 metra. A din çka është bërë aty, hajde dalim aty të bëjmë presion se i kemi edhe 400 metra aty është thënë 815 metra shtrohet sepse janë prej Zyrës së Prokurimi, mirëpo edhe pjesa tjetër ka me u shtrë kur ti vjen koha.

z.Ekrem Abazi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Remzi, po të thamë që at mendim që e kame than para dy tre muajve qëndroj prapë, sepse e njëjta situatë është, bile tash është një risi, që kanë fillu me marr nga komunat tjera, kjo është plus risi tjetër. Sa i përket atyre gypave që i pasni qu ne Goshicë, për ujë, po me vjen shumë mirë, po ata kanë me nejt një kohë të gjatë qashtu, sepse nuk ka ujë dhe kjo me shtyri me bërë një pyetje, çka është ka ndodhë me ujin nga Letnica që vjen në Viti. CDI-ja i ka pagu të gjitha obligimet që i ka pas edhe na si komune besoj që ja kemi pagu obligimet ati punëkryesit, ujë nuk ka. Para dy viteve në fushatë u përmend gjithmonë gypat kancerogjen, për çdo ditë e kanë përmend këtë, tash që 1 vit gypat janë e ujë nuk kemi. Ne në Viti pim ujë shumë të trubull. Shifni, i pari që vjen hin uji i arave. E sa i përket KPF-së, na vitin e kaluar patëm bërë kërkesë që në buxhetin e ardhshëm, që me u definu të gjitha paret se ku kanë me shku. Keni thanë vet po edhe ne kuvend edhe ne KPF, qëllimi ynë ka qenë që ai buxhet mu definu po ju nuk keni dashtë me hi aty, sepse mbi 50% është i pa definuar, d.m.th kur është buxheti i padefinuar, ku qytetarët tanë nuk e dinë ku shkon ai buxhet, atëherë ju ja përshtatni individit, atëherë e kam thanë, edhe tash po e përsëris, në Viti ka lagje që nuk ka kanalizim, nuk ka asfalt. Sa i përket zhavorrit, këta nuk shtrojnë zhavorr, këta janë tu shtrë lloq 110 mije euro, edhe vitin e ardhshëm kanë mu nda për lloq, këta janë tu e hek lloqin të gurthyesit, e me qit ne ara tona. Keshyre buxhetin, nuk janë të konkretizuar se ku ka mu investu, punën e kryeni ju aty ku vjedhni më së shumt. Ne nuk kemi rekomandu në KPF që me ardh kështu, na kemi pas me rekomandu nëse buxheti ka qenë i definuar, bile bile 85% ku ka me shku, po ju nuk keni dashtë ashtu, tash i keni bërë votat.

Kryesuesi z.Naim Pira: U parashtu një numër i pyetjeve, nëse ka përgjigjej dikush prej drejtorëve urdhëroni, nëse jo, ju lutem në seancën e ardhshme përgatitni pyetjet. Për seancën e tetë të rregull të Kuvendit Komunal të Vitisë, kemi parapa këtë:

Rend dite

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e Kuvendit Komunal të Vitisë.**
- 2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për projekt buxhetin e Komunës së Vitisë 2020-2022.**
- 3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2020.**
- 4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2020**
- 5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për planin e punës se Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2020.**

A ka dikush rreth rendit të ditës, pasi që nuk ka e qes ne votim miratimin e rendit të ditës konstatoj që me 14 vota pro miratohet rendi i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e shtat e Kuvendit Komunal të Vitisë**

A ka dikush rreth pikës së parë të rendit të ditës ju lutëm? Pasi nuk ka e hedhim në votim pikën e parë të rendit të ditës. Konstatohet se me 14 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim miratohet pika e parë e rendit të ditës.

Si pike të dytë të rendit të ditës kemi:

2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për projekt buxhetin e Komunës së Vitisë 2020-2022

z.Ibrahim Rama: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kisha pas dëshirë që në këtë dokument me marr pjesë edhe përfaqësuesi e opozitës, gjithnjë duke menduar se buxheti perime e përgatit qeveria që është ne pushtet, po buxheti është transformim i të gjitha ideve që kanë të bëjnë me qytetaret e që reflekton përmes këtij dokumenti dhe që në të gjitha vendimet që I merr kuvendi komunal. Unë konsideroj që këtë dokument kish pas dëshirë që të gjithë ata që merren me këtë punë me marr pjesë dhe me ndiku, me mendu drejt në këtë dokument dhe të gjithë qytetaret janë pjesë që përfitojnë nga ky dokument I buxhetit. Është një proces I gjatë që ka filluar dikune me 15 Maj e që përfundon me këtë seancë. Nëse ju jeni të pajtimit, është një pune voluminoze që behet gjithnjë jo tu mendu në interesat parciais klanore apo edhe politike siç e ceken parafolësit, po është një dokument që janë inkorporu shumë kërkesa edhe të shoqërisë civile edhe të sektorit të biznesit edhe të sportit. Të gjitha ato mundësi që janë parashtru përmes kërkesave, jemi mundu me I inkorporu në këtë buxhet. Shuma buxhetit nuk është sovranitet që e cakton qeveria komunale, po është kriter që e cakton Ministria e Financave, gjegjësisht nga Kuvendi i Republikës se Kosovës dhe në këtë drejtim ne këtë buxhet e kemi marr kornizën afatmesme. Ju e dini e kemi miratu edhe në kuvend këtu edhe e kemi intepretu para qytetarëve, pra është intereson mu marr me buxhetin gjithmonë duke e jek anën negative të paragjykimit për një buxhet. Gjithherë jemi mundu me nda buxhetin drejt dhe duke I prekur strukturat e qytetarisë ne nivel administrative te Komunës se Vitisë. Buxhetet komunale nuk behën për partitë politikë, nuk behet as për qeveri komunale, buxhetet përgatiten dhe transformohen për qytetarë. Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2020 baze tri kriterëve që janë ne ministrin e financave në shumë prej 12,305,491 €. Këtë shumë ne duhet me e menaxhu dhe me shpërnda sa është e mundur drejt të gjitha rrethanat që ndikojnë në përgatitjen e këtij dokumenti i kemi marr për bazë. Nuk po ju marr kohë më shumë, materialin e keni marr me kohë, unë për pyetje shtesë jam ne dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Ne këtë buxhet e kemi asfaltimin e rrugëve, konkretisht asfaltimin e rrugës në Terpezë atje tek pishat, që është kërkesë e banorëve të këtij lokaliteti po edhe e banorëve përreth, dhe kemi ndërtimin e fushës së futbollit në Pozharan, që kryetari i komunës e ka siguru buxhetin për fushën ndihmëse në Pozharan dhe njerëzit që po qesin lot krokodili, sot e kanë lëshu seancën e kuvendit dhe nuk marrin pjesë në votimin e projektbuxhetit. Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm? Pasi që nuk ka për me marr fjalën, e qes në votim për miratim. Kush është që të miratohet ky projektbuxhet. Të pranishëm në sallë janë 14 këshilltar, me votat e 14 këshilltarëve miratohet projektbuxheti.

Si pikë të tretë kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2020.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Të nderuar këshilltar të kuvendit komunal! Pjesë e buxhetit kur të miratohet buxheti, pjese e kësaj janë dy dokumente bazë që e plotësojnë financimin e buxhetit komunal. Pra, këto janë rregullorja mbi tatimin në pronë dhe rregullorja për gjoba, ngarkesa dhe taksa. Pra, sot, krahas buxhetit i kemi edhe këto dy rregullore që krijojnë të hyra për Komunën e Vitisë. Bazë këtyre të hyrave plotësohet edhe buxheti. Propozim rregulloret i keni marr me kohë, për pyetje shtesë jam në dispozicioni e juaj.

Kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. Pasi nuk ka për diskutim, unë po i qes në votim. Të pranishëm janë 14 këshilltar, me 14 vota pro miratohet Rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoba.

Si pikë të katërt të rendit të ditës kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2020

Drejtori z.Ibrahim Rama: Edhe kjo është një rregullore bazë, që e plotëson buxhetin e komunës. Ndryshime në këtë rregullore nuk ka. Materialin e kemi marr me kohë, për pyetje shtesë urdhëroni jam në dispozicioni e juaja.

Kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. Pasi nuk ka për diskutim, unë po i qes në votim. Të pranishëm janë 14 këshilltar, me 14 vota pro miratohet Rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2020.

Si pikë të pestë për sot kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2020.

Kemi qen të gatshëm dhe të disponueshëm vazhdimisht, që një plan të punës së kuvendit komunal çdo vit e kemi sjell para juve. Këtë vit kemi pas edhe punëtori dhe planit të punës së Kuvendit Komunal. Është një plan I punës, i cili duhet të miratohet së bashku me buxhetin. Materialin e kemi marr me kohë, unë hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi nuk ka për diskutim, unë po i qes në votim. Të pranishëm janë 14 këshilltar, me 14 vota pro miratohet plani i punës së Kuvendit komunal të Vitisë 2020.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 11:35 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Naim Pira
